

VENDIM
Nr. 544, datë 13.6.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
KALIMASH - MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash – Morinë.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme (objekte), që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë totale 8 084 821 (tetë milionë e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzet e një) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 5. Vlera totale e shpronësimit, prej 8 084 821 (tetë milionë e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzet e një) lekësh, të përballohet nga zëri “Shpronësime”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për vitin 2013.
 6. Shpronësimi të fillojë më 15.6.2013.
 7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 8. Autoriteti Rrugor Shqiptar do të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, sipas pikës 6 të këtij vendimi.
 9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra e Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR KALIMASH-MORINË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas	Objekte vlera lekë	Shënime
1	Mus	Tahir	Matmuja	1176	263/10	3825166	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Rizan	Mem	Dida	1176	276	4259655	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		TOTALI				8084821	